

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVENDIMIN**  
**PËR**  
**MIRATIMIN E STRATEGJISË SEKTORIALE TË TRANSPORTIT DHE**  
**PLANIT TË VEPRIMIT 2030**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky projektvendim ka për qëllim miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të saj të Veprimit 2030, si dokumenti kryesor që përcakton drejtimin e zhvillimit të sektorit në përputhje me prioritetet kombëtare dhe procesin e integritimit evropian.

Strategjia synon zhvillimin e një sistemi transporti modern, të sigurt dhe të qëndrueshëm, që përmirëson lidhshmërinë, rrit eficiencën ekonomike dhe garanton akses më të mirë për qytetarët dhe bizneset, në linjë me vizionin e Bashkimit Evropian.

Objektivat kryesore të Strategjisë janë:

- përafrimi me *acquis* të BE-së dhe zbatimi efektiv i tyre;
- zhvillimi i infrastrukturës dhe integrimi me rrjetin TEN-T;
- promovimi i lëvizshmërisë së sigurt, të qëndrueshme, inteligjente dhe multimodale;
- rritja e sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve;
- forcimi i kapaciteteve institucionale dhe koordinimit.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK DHE DOKUMENTET STRATEGJIKE**

Strategjia Sektoriale e Transportit dhe Plani i Veprimit 2030 është në përputhje dhe e harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030, Programin e Qeverisë 2025–2029 dhe Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës.

Ajo është gjithashtu e harmonizuar me kuadrin strategjik të Bashkimit Evropian dhe iniciativat rajonale, përfshirë Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane, Planin Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor dhe Strategjinë për Lëvizshmëri të Qëndrueshme dhe Inteligjente.

Miratimi i këtij projektvendimi është i planifikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2026.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME**

Spektori i transportit në Shqipëri ka shënuar progres të konsiderueshëm në drejtim të modernizimit të infrastrukturës, përafrimit ligjor dhe rritjes së kapaciteteve operacionale. Megjithatë, ai vijon të përballet me sfida strukturore që lidhen me nevojën për investime të mëtejshme në rrjetet prioritare, përmirësimin e koordinimit ndërinstucional, rritjen e nivelit të digjitalizimit dhe zhvillimin e një sistemi të integruar multimodal.

Në veçanti, kërkohet një qasje më e strukturuar për përshpejtimin e integritimit me rrjetin TEN-T, forcimin e kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit të BE-së, si dhe përmirësimin e mekanizmave të planifikimit dhe monitorimit të investimeve në sektor.

Miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit adreson këto sfida përmes një kuadri të qartë prioritetesh, objektivash dhe masash konkrete, të shoqëruara me tregues të matshëm dhe përgjegjësi të përcaktuara institucionale. Dokumenti vendos një bazë të konsoliduar për orientimin e investimeve publike dhe mobilizimin e financimeve nga partnerët ndërkombëtarë.

Efektet e pritshme përfshijnë përmirësimin e ndjeshëm të lidhshmërisë kombëtare dhe rajonale, rritjen e eficiencës së transportit dhe uljen e kostove logjistike për ekonominë, përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve për përdoruesit, si dhe reduktimin e ndikimeve mjedisore në përputhje me objektivat e tranzicionit të gjellbër.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Projektvendimi i propozuar është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe me kuadrin ligjor në fuqi në sektorin e transportit, përfshirë legjislacionin sektorial për transportin rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror.

Strategjia dhe Plani i Veprimit janë të harmonizuara me legjislacionin horizontal që rregullon çështje të tilla si prokurimi publik, zhvillimi territorial, mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, si dhe me politikat kombëtare për zhvillimin ekonomik dhe integrimin evropian.

Në të njëjtën kohë, dokumenti kontribuon drejtpërdrejt në procesin e përafrimit me *acquis* të Bashkimit Evropian në sektorin e transportit, në kuadër të Kapitullit 14 (Politika e Transportit), Kapitullit 21 (Rrjetet Trans-Evropiane) dhe Kapitullit 27 (Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike), duke mbështetur përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i negociatave për anëtarësim.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE***

Projektvendimi në vetvete nuk përafron drejtpërdrejt akte të Bashkimit Evropian.

Megjithatë, Strategjia Sektoriale e Transportit dhe Plani i Veprimit 2030 parashikojnë një sërë masash dhe ndërhyrjesh me objektiv përafrimin e mëtjshëm të legjislacionit kombëtar me *acquis* të Bashkimit Evropian, si një nga prioritetet kryesore të sektorit.

Në këtë kuadër, Strategjia adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë përmbushjen progresive të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit evropian, duke përfshirë harmonizimin ligjor, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe zbatimin efektiv të standardeve të BE-së në të gjitha llojet e transportit.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi përmban dy pika në të cilat parashikohet, përkatësisht:

- Në pikën 1, miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2030, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- Sipas pikës 2, ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ministritë dhe institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e kësaj strategjie dhe planit të veprimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim parashikon hyrjen në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## **VII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE ORGANET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Strategjia Sektoriale e Transportit dhe Planit i Veprimit 2030 është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me institucionet dhe agjencitë e sektorit të transportit pjesë e planit të veprimit të kësaj Strategjie, me mbështetje teknike nga konsulenca e kontraktuar nga Sekretariati i Komunitetit të Transportit.

## **VIII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2030 ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si institucioni përgjegjës për hartimin e politikave dhe koordinimin e sektorit të transportit në nivel kombëtar, si dhe ministritë dhe institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e kësaj strategjie dhe planit të veprimit.

Zbatimi i masave dhe ndërhyrjeve të parashikuara do të realizohet në bashkëpunim me institucionet përkatëse sektoriale, përfshirë autoritetet rregullatore dhe zbatuese sipas llojeve të transportit, si dhe me njësitë e qeverisjes vendore për aspektet që lidhen me transportin urban dhe zhvillimin territorial, sipas përgjegjësive të përcaktuara në Planin e Veprimit.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Zbatimi i Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2030 kërkon mobilizimin e burimeve të konsiderueshme financiare, kryesisht për shkak të investimeve madhore në infrastrukturën e transportit, veçanërisht në kuadër të zhvillimit të rrjetit TEN-T në sektorin rrugor dhe hekurudhor.

Në Planin e Veprimit janë përcaktuar institucionet përgjegjëse për sigurimin e financimit të aktiviteteve, përmes një kombinimi burimesh, përfshirë buxhetin e shtetit, burimet e brendshme institucionale, si dhe financimet nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare, duke garantuar qëndrueshmërinë financiare të ndërhyrjeve të propozuara.

Plani i Veprimit mbështetet në programimet ekzistuese financiare, përfshirë Programin Buxhetor Afatmesëm dhe Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, duke reflektuar prioritetet dhe projektet e identifikuara në këto instrumente. Njëkohësisht, ai shërben si bazë referimi për rishikimin dhe përditësimin e tyre, duke siguruar koherencë ndërmjet planifikimit strategjik dhe programimit buxhetor.

Totali i shpenzimeve të investimeve të parashikuara për Strategjinë është afërsisht €7.9 miliardë për periudhën 2026–2030. Disa nga investimet madhore mund të nisin brenda periudhës së Strategjisë po do shtrihen përtej saj. Kostot e paraqitura në Planin e Veprimit janë indikative dhe ndryshojnë në mënyrë dinamike në varësi të progresit të zbatimit.

**MINISTRI**

**ENEA KARAKAÇI**